



Breaking News: Raporti 24-orësh i ngjarjeve, 5 maj 2023



05/05/2023

# Tiranë – Vihen Në Pranga 4 Shtetas Dhe Procedohet Në Gjendje Të Lirë 1 Tjetër, Për Vepra Të Ndryshme Penale

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Nr. 1 arrestuan shtetasin B. G., 34 vjeç, banues në Tiranë, pasi ka thyer masën e sigurisë “Arrest në shtëpi”.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Nr. 5 arrestuan shtetasin M. A., 28 vjeç, banues në Tiranë, pasi ka ushtruar dhunë ndaj bashkëshortes së tij.

Specialistët e Qarkullimit Rrugor arrestuan shtetasit:

- A. M., 63 vjeç, banues në Tiranë, pasi duke drejtuar automjetin, në gjendje të dehur, është përplasur me një automjet tjetër, me pasojë vetëm dëme materiale;

– A. H., 47 vjeç, banues në Tiranë, pasi u kap duke drejtuar automjetin, në gjendje të dehur.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Nr. 1 referuan materialet në Prokurori dhe nisi procedimi penal për shtetasin F. Sh., 20 vjeç, sepse më datë 04.05.2023, në oborrin e një shkolle, në Farkë, Tiranë, ka qëlluar në ajër, me një pistoletë imituese të zhurmës së armëve. Pistoleta imituese u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Në Komisariatin e Policisë Nr. 6 është paraqitur shtetasja D. N., 63 vjeçe, banuese në Tiranë, e cila ka bërë kallëzim se është larguar nga banesa, bashkëshorti i saj, shtetasi Gj. N., 77 vjeç. Punohet për gjetjen e tij.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Berat – Kreu veprime të turpshme ndaj një shtetaseje të mitur, kapet dhe vihet në pranga 59-vjeçari

DVP Vlorë – Vihen në pranga 2 shtetas dhe procedohet në gjendje të lirë 1 tjetër, për vepra të ndryshme penale ▶